

GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE TË NJERIUT

SEKSIONI I TRETË ÇËSHTJA ZAJMI KUNDËR SHQIPËRISË (Kërkesa nr. 83907/17)

VENDIM

STRASBURG
20 qershor 2023

Ky vendim është i formës së prerë, por mund të bëhet objekt i një rishikimi redaktues.

Në çështjen Zajmi kundër Shqipërisë,

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë), e mbledhur si një Komision i përbërë nga:

Georgios A. Serghides, *kryetar,*

Darian Pavli,

Oddný Mjöll Arnardóttir, *gjyqtarë*

dhe Olga Chernishova, *zëvendëssekretare e Seksionit,*

duke pasur në konsideratë:

kërkesën (nr. 83907/17) kundër Republikës së Shqipërisë paraqitur pranë Gjykatës, në mbështetje të nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (“Konventa”), më 12 dhjetor 2017, nga një shtetase shqiptare, znj. Çetina Zajmi, lindur në vitin 1957 dhe banuese në Tiranë (“kërkuesja”), e cila u përfaqësua nga z. O. Samarxhi, avokat i cili ushtron profesionin në Tiranë;

vendimin për të njoftuar qeverinë shqiptare (“Qeveria”) për kërkesën, përfaqësuar nga ish-Agjentët e saj, znj. A. Hiçka dhe z. A. Metani, dhe më pas nga z. O. Moçka nga Avokatura e Shtetit; parashtrimet e qeverisë;

pasi diskutoi me dyer të mbyllura, më datë 30 maj 2023,

shpall vendimin e mëposhtëm, i cili u miratua në po atë datë:

LËNDA E ÇËSHTJES

1. Çështja ka të bëjë me procedurat penale ndaj kërkueses, ku ajo u shpall fajtores për mashtrim të rëndë dhe u dënua me katërmëbëdhjetë vite burgim nga Gjykata e Rrethit Tiranë, më 13 mars 2013. Apeli i kërkueses u rrëzua nga Gjykata e Apelit Tiranë, më 8 nëntor 2013. Në vijim, kërkuesja depozitoi një apelim tjetër pranë Gjykatës së Lartë, e cila e rrëzoi më 25 maj 2015.

2. Në datën 8 nëntor 2016, në Fletoren Zyrtare u publikua ligji nr. 99/2016, i datës 6 nëntor 2016. Sipas këtij ligji shkurtrohej afati për dorëzimin e një ankese kushtetuese nga dy vite në katër muaj “nga konstatimi i cenimit [i një të drejte apo lirie kushtetuese]”. Gjithashtu, ky ligj parashikonte se afati i ri hynte në fuqi më 1 mars 2017.

3. Në datën 27 shkurt 2017, kërkuesja dërgoi me anë të postës një ankese kushtetuese. Mbi zarf, ajo kishte vendosur adresën: “Gj – K.SH., Tiranë”.

4. Në një datë të papërcaktuar, kërkuesja iu drejtua zyrës postare për të konfirmuar nëse dërgesa e saj ishte dorëzuar pranë Gjykatës Kushtetuese, dhe u bë me dije se dërgesa nuk ishte dorëzuar, sepse marrësi i dërgesës së saj nuk mund të identifikohet pasi emri dhe adresa nuk ishin të plota.

5. Kërkuesja e ridërgoi ankesën e saj kushtetuese në adresën e duhur të Gjykatës Kushtetuese më 22 maj 2017. Ajo u shpall e papranueshme pasi ishte dorëzuar jashtë afatit katërmujor, më 16 qershor 2017.

6. Më 16 qershor 2017, Gjykata Kushtetuese miratoi dy vendime të tjerë për çështjen Pajova (vendimi nr. 157) dhe Ibrahimimi (vendimi nr. 152) tek të cilët u zbatua afati katërmujor i sapomiraturar, në lidhje me vendimet e Gjykatës së Lartë, miratuar respektivisht më 7 maj 2015 dhe 25 qershor 2015, duke e nisur llogaritjen që nga data kur këto vendime u miratuan.

VLERËSIMI I GJYKATËS

7. Parimet e përgjithshme, në lidhje me të drejtën për t'iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë, në lidhje me afatin e sapomiraturar katërmujor për depozitimin e një ankese kushtetuese në Shqipëri, janë përmbledhur në vendimin *Çela kundër Shqipërisë* (nr. 73274/17, §§ 20, 27–29 dhe 32, 29 nëntor 2022).

8. Gjykata vëren se vendimi i formës së prerë shpallur nga Gjykata e Lartë u miratua më 25 maj 2015 dhe në atë periudhë, afati për depozitimin e një ankese kushtetuese ishte dy vite duke e nisur llogaritjen nga miratimi i vendimit të Gjykatës së Lartë. Ligji i ri, që shkurtonte afatin në një periudhë katërmujore, u publikua më 8 nëntor 2016, dhe parashikonte se afati i ri do të ishte i zbatueshëm që prej datës 1 maj 2017. Kërkuesja depozitoi ankesën e saj kushtetuese më 22 maj 2017, brenda afatit dyvjeçar. Megjithatë, Gjykata Kushtetuese e shpalli ankesën të papranueshme pasi ishte depozituar jashtë afatit katërmujor, duke nisur llogaritjen nga data e miratimit të vendimit të Gjykatës së Lartë.

9. Gjykata vëren se, fillimisht, kur u miratua ligji në të cilin parashikohej afati katërmujor, nuk ishte e qartë nëse ai ligj do të zbatohet edhe për vendimet e kontestuarra të miratuara përpara datës 1 mars (shih *Çela*, cituar më sipër, §§ 36–39). Gjykata Kushtetuese e bëri të qartë pozicionin e saj jo më vonë se data 16 qershor 2017, kur u miratuan vendimet e saj për çështjen e ankueses dhe për çështjet Pajova dhe Ibrahimimi (shih paragrafët 5 dhe 6 më sipër, shih edhe *Çela*, cituar më sipër § 6), duke lënë në fuqi gjykimin se afati dyvjeçar nuk zbatohet që prej datës 1 mars 2017, dhe se çdo ankese kushtetuese e depozituar pas asaj date do t'i nënshtrohet afatit katërmujor për të gjitha çështjet pa përjashtim. Një gjë e tillë nënkuptonte se për sa kishte të bënte me të gjitha çështjet për të cilat vendimi i Gjykatës së Lartë (apo vendimet e tjera të formës së prerë të kontestuarra) ishte miratuar përpara datës 1 nëntor 2016, ankimet kushtetuese do të duhej të ishin depozituar deri më 1 mars 2017, dhe nëse nuk përmbushej një kusht i tillë, ankimet do të shpallehin të papranueshme.

10. Gjykata tashmë kishte shprehur gjykimin e saj për çështjen *Çela*, se një interpretim i tillë i afatit të ri nuk kishte qenë mjaftueshëm i parashikueshëm, për ankesat e mundshme kushtetuese të datës 1 mars 2017. Ligji i ri, që parashikonte një afat më të shkurtër, nuk do të mund të zbatohet për ankesën kushtetuese të kërkueses pasi ishte depozituar më 22 maj 2017, kur qëndrimi i Gjykatës Kushtetuese për faktin se afati i ri do të zbatohet edhe për vendimet e kontestuarra të miratuara përpara datës 1 mars 2017, nuk ishte zbatuar ende qartazi në praktikë (shih *Çela*, cituar më sipër § 37). Në këtë mënyrë, një afat dyvjeçar për depozitimin e një ankese kushtetuese do të ishte i zbatueshëm në çështjen konkrete. Një gjykim i kundërt do të ishte në kundërshtim me parimin e sigurisë ligjore (shih *Çela*, cituar më sipër, § 38). Gjykata vëren se ankesa e kërkueses për adresën e duhur të Gjykatës Kushtetuese ishte depozituar brenda afatit dyvjeçar.

11. Në këto rrethana, Gjykata është e mendimit se vendimi i kundërshtuar i Gjykatës Kushtetuese, që rrëzonte ankesën kushtetuese të kërkueses pasi ishte depozituar jashtë afatit, sillte mohimin e pajustificuar të së drejtës së kërkueses për t'iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese. Për rrjedhojë, është shkelur neni 6 § 1 i Konventës.

ZBATIMI I NENIT 41 I KONVENTËS

12. Kërkuesja nuk paraqiti në kohë një kërkesë për shpërblim të drejtë. Sipas këtyre rrethanave, Gjykata shprehet se nuk ka shkaqe që kërkueses t'i akordohet ndonjë shumë për këtë aspekt.

PËR KËTO ARSYE, GJYKATA, UNANIMISHT,

1. *E shpall* kërkesën të pranueshme;
2. *Gjykon* se është shkelur neni 6 § 1 i Konventës.

Hartuar në gjuhën angleze dhe njoftuar me shkrim më datë 20 qershor 2023, sipas Rregullit 77 §§ 2 dhe 3, të Rregullores së Gjykatës.

Georgios A. Serghides
KRYETAR

Olga Chernishova
ZËVENDËSSEKRETARE